

VENDIM
Nr. 743, datë 20.11.2019

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 752, DATË 5.9.2013,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT “BULEVARDI VERIOR DHE
REHABILITIMI I LUMIT TË TIRANËS”, FAZA I, NË BASHKINË E TIRANËS”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 dhe 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 752, datë 5.9.2013, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) pika 2 ndryshohet si më poshtë vijon:

“2. Pronarët dhe poseduesit e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelat bashkëlidhur dhe janë pjesë përbërëse të këtij vendimi, për sipërfaqen 39 646.8 (tridhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e dyzet e gjashtë pikë tetë) m², truall, me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 938 126 675 (nëntëqind e tridhjetë e tetë milionë e njëqind e njëzet e gjashtë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekësh, dhe për 206 objekte me vlerë 827 942 327 (tetëqind e njëzet e shtatë milionë e nëntëqind e dyzet e dy mijë e treqind e njëzet e shtatë) lekësh.”.

b) pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Vlera e plotë e shpronësimit, prej 1 766 069 002 (një miliard e shtatëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milionë e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e dy) lekësh, do të përballohet në masën 550 000 000 (pesëqind e pesëdhjetë milionë) lekë nga llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë, dhe pjesa e mbetur nga fondet e buxhetit të Bashkisë Tiranë.”.

c) pas pikës 3 shtohet pika 3.1, me këtë përmbajtje:

“3.1 Vlera e shpenzimeve procedurale, prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekësh, do të përballohet nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.”.

ç) në tabelat bashkëlidhur vendimit bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

i. të dhënat e nënndarjeve me nr. rendor 14, 61, 68, 69, 12, 45, 25, 7, 46, 56 dhe 34 ndryshohen sipas tabelës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

ii. shtohen nënndarjet me të dhënat, sipas tabelës nr. 2 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Tiranë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

TABELA “PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 752, DATË 5.9.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI ‘BULEVARDI VERIOR DHE REHABILITIMI I LUMIT TË TIRANËS’, FAZA I, NË BASHKINË E TIRANËS”, TË NDRYSHUAR

Tabela që pasqyron ndryshimet e bëra në tabelën bashkëlidhur VKM-së nr. 752, datë 5.9.2013

Tabela nr. 1

Nr. rendor sipas VKM-së nr. 752	Kodi i obj. në hartë	ZK	Nr. i pas.	Emri i pronarit	Sipërf. truall/obj., m ²	Çmimi i truallit	Vlera e truallit	Vlera e objektit	Vlera totale e shpronësimit	Lloji i dokumentit	Shënime
14	4/1	8330	7/86	BP Njuma, Këllezi	256	26137	6691072	1121640	7,812,712		
61	48	8340	8/274	BP Vorpsi, Qordja, Petrela, Ago, Androja, Zelka				7011593	7,011,593		
68	56	8340	8/230	“Erda” sh.p.k., Frederik Prenjasi				2425602	2,425,602		
69	56/1	8340	8/226	“Erda” sh.p.k., Frederik Prenjasi				7363744	7,363,744		
12	P9/1	8330	7/77	BP Dervishi, Domi				1050502	1,050,502		
45		8330	7/482	Mustafa, Besnik dhe Adnand Alla	108	26137	2822796	0	2,822,796	Konf. me shkresat nr. 10146/1, datë 16.4.2018 dhe nr. 10146/3, datë 14.5.2018 nr. prot. të ZVRPP-së Tiranë	
25		8330	7/493	BP Nesturi, Goxheri, Vuka, Gjoka, Voci	27	26137	705699	0	705,699	Konf. me shkresën nr. prot. 655/1, datë 9.7.2019	
			7/494	Rexhep Zeneli	265	26137	6926305	0	6,926,305	Konf. me shkresën nr. prot. 655/1, datë 9.7.2019	
7		8340	8/266	BP Mezini, Maloku, Kodra	1331	23217	30901827	0	30,901,827	Konf., nr. prot. 4339/1, datë 22.2.2017, të ZVRPP-së Tiranë	Bllkohet në favor të shoqërisë “Alban Tirana CO” sh.p.k.
46		8330	7/77	BP Dervishi, Domi	109.7	26137	2867229	0	2,867,229	Konf. me shkresën nr. prot. 14566/1, datë 2.5.2019, të ASHK-së Tiranë	
56		8340	8/243	BP Shehu, Sina, Serezi, Kuçi, Uruçi, Topi	3465	23217	80446905	0	80,446,905	Konf. me shkresën nr. prot. 4339/1, datë 22.2.2017 të ZVRPP-së Tiranë	Ka 18 (tetëmbëdhjetë) ndërtime të paligjshme
34		8330	7/72	Nazmi Kolgjegja	104	26137	2718248	0	2718248	Konf. me shkresat nr. prot. 6606/1, datë 6.6.2017 dhe nr. prot. 33880/1, datë 3.10.2018, të ZVRPP-së Tiranë	Mbi këtë truall ka një ndërtim të paligjshëm
Shuma					5665.7				153,053,162		

Tabela që pasqyron pasuritë e shtuara

Tabela nr. 2

Nr. rendor	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Emri i pronarit	Sipërf. truall/obj. m ²	Çmimi i truallit	Vlera e truallit	Vlera e objektit	Vlera totale e shpronësimit	Lloji i dokumentit	Shënime
1	8330	7/309	BP Lleshi, Kuqi, Pitarka, Xhafa, Jareci, Firzja, Mici	179	26137	4678523		4678523	Konf me shkresat nr. prot. 13876/1, datë 26.11.2015; nr. prot. 4339/1, datë 22.2.2017, të ZVRPP-së Tiranë	Ndalon veprimet mbi pasurinë deri në zgjidhjen e problemit të krijuar nga regjistrimi i parregullt në sistemin hipotekar.
2	8340	8/231	“Alb-Italia Construzioni” s.r.l. sh.p.k.	16 m ² dhe 50.8 m ² objekt	23217	371472	2018715	2390187	Konf. me shkresat nr. prot. 5101/1, datë 29.4.2014; nr. prot. 6606/1, datë 6.6.2017, të ZVRPP-së Tiranë	
3	8340	1/71	Sami Sada	158	23217	3668286		3668286	Konf. me shkresat nr. prot. 34586/2, datë 28.12.2015; nr. prot. 4339/1, datë 22.2.2017, të ZVRPP-së Tiranë	
4	8330	7/74	BP Tresa	101	26137	2639837		2639837	Konf. me shkresat nr. prot. 23798/1, datë 5.8.2016; nr. prot. 4339/1, datë 22.2.2017, të ZVRPP-së Tiranë	
5	8330	7/454	Arian, Seladin dhe Zyra Fetishaj	6	26137	156822		156822	Konf., nr. prot. 6606/3, datë 30.10.2017, të ZVRPP-së Tiranë	Titulli i pronësisë i kësaj pasurie përfshin dhe pasurinë nr. 7/455, vol. 35, f. 164, e cila është kufizuar për efekt mbivendosje.
6	8330	7/456	Bashkëpronarët Fetishaj, Bukeli, Kallushi dhe Koleci	48.3	26137	1262417		1262417	Konf., nr. prot. 6606/3, datë 30.10.2017 të ZVRPP-së Tiranë	Titulli i pronësisë i kësaj pasurie përfshin dhe pasurinë nr. 7/457, vol. 35, f. 166, e cila është e kufizuar për efekt të mbivendosjes.
7	8330	7/102	Bashkëpronarët Demiri	34	26137	888658		888658	Konf. me shkresën nr. prot. 28374/1, datë 18.8.2018	
8	8340	8/453	BP Selimaj	38	23217	882246		882246	Konf. me shkresën nr. prot. 2731/1, datë 14.2.2019	
9	8340	8/25/ND	Azem, Gani Shalca	7 m ² objekt			234399	234399		
Vlera totale				564.3		148628342	21226195	16801375		